



# Mbrojtja e shëndetit dhe zgjedhjet

„Krizja Covid 19 ka shkaktuar dëme të mëdha, me humbjen e jetës së njerëzve, si dhe dëme në ekonominë dhe sistemet shëndetësore në të gjithë botën. Kjo gjithashtu është e rrezikshme edhe për demokracinë.”

-Kryetarë dhe drejtorë ekzekutiv i IFES, Entoni N. Barnabi

Zhvillimi i demokracisë bazohet në mitingje popullore, transparencë dhe besim në zgjedhje dhe institucione qeveritare - dhe të gjitha këto janë në rrezik për shkak të pandemisë së Covid-19. Kriza globale e shëndetit ndodhë në një moment kur tashmë ekziston shqetësimi i [rënies globale të demokracisë](#). Deri tani [më shumë se 50 vende](#) kanë shtyrë ose kanë anuluar zgjedhjet, dhe të tjerët po përdorin krizën si një justifikim për konsolidimin e shpejtë të pushtetit dhe shkelje të të drejtave individuale.

***Seria e re e botimeve të IFES për Covid 19*** përfshin shtatë fusha kryesore ku ekziston shqetësimi për demokracinë dhe qeverisjen për shkak të pandemisë.

Përderisa shkelen të drejtat demokratike dhe qeverisëse, gjithashtu është dëmtuar aftësia e qeverive që t'u përgjigjur në mënyrë të duhur nevojave të njerëzve që vuajnë nga kriza me Covid-19, përfshirë këtu ata që janë tashmë të marginalizuar dhe të cilët mund të pësojnë dëme proporcionale. Demokracia e qëndrueshme me qeverisje të mirë siguron mundësinë më të madhe për të trajtuar epidemitë me viruset dhe pasojat më të gjera të një pandemie. Prandaj, roli i zgjedhjeve dhe pjesëmarrja e publikut janë edhe më të rëndësishme gjatë Covid-19.

Si mund të mbahen zgjedhje të sigurta në kohën e pandemisë së Covid-19 dhe krizave të tjera të shëndetit publik?

***Mbrojtja e shëndetit dhe zgjedhjet***, botimi i parë i kësaj serie, jep përgjigje për pyetjet nga funksionarët shtetërorë përfshirë autoritetet e zgjedhjeve dhe palët e tjera të interesuara në fushën e demokracisë dhe qeverisjes, organizatat e shoqërisë civile, krijuesit e politikës dhe mbështetësit.

„Mirëmbajtja e zgjedhjeve në mes të një krize të shëndetit publik është e mundur, megjithatë, nevojitet planifikim domethënës për të shmangur përkeqësimin e situatës tashmë komplekse.”

Ky dokument pasqyron përvojat e ekspertëve të zgjedhjeve dhe shëndetit publik, dhe ofron udhëzime kryesore për zvogëlimin e rreziqeve për votuesit dhe zyrtarët e zgjedhjeve. Janë adresuar një numër i madhë sfidash, duke filluar nga një vendim kryesor nëse do të zhvillohen zgjedhjet me votim personal. Gjithashtu qëllimi është zvogëlojë kërcënimet ndaj demokracisë duke anuluar dhe duke shtyrë zgjedhjet, të cilat mund të parandalohen përmes planifikimit të duhur.

## ***Mbrojtja e shëndetit dhe zgjedhjet:***

- **Jep një kornizë** për funksionarët shtetërorë, siç janë organet zgjedhore dhe palët e tjera të interesuara, duke marrë parasysh aspektet e shëndetit publik në faza të ndryshme të procesit zgjedhor.
- **Konsideron qëllimin dhe karakterin** sfidues të shëndetit publik që posaçërisht e imponoi Covid-19 për zgjedhjet.
- **Ofron rekomandime dhe strategji** për zvogëlimin e rreziqeve të shëndetit publik gjatë aktiviteteve specifike të nevojshme për të zhvilluar zgjedhjet legjitime.
- **Identifikon burimet dhe materialet themelore** të cilat janë të nevojshme për zbatimin e strategjive për zvogëlimin e rreziqeve.
- **Siguron një përmbledhje të qasjeve** për monitorimin dhe matjen e cilësisë me të cilën zbatohen strategjitë e propozuara.

„Më shumë 40 aspekte të procesit zgjedhorë kërkojnë mbledhjen e njerëzve ose transferimin e objekteve, gjë që paraqet rrezik të transferimit të virusit nëse nuk merren masa parandaluese.”

IFES rekomandon për funksionarët shtetërorë dhe organet e zgjedhjeve që:

- **Të komunikojnë dhe të kordinohen** me autoritetet kompetente të shëndetit publik dhe ekspertët.
- **Të parandalojnë ose të zvoglojnë bashkëveprimin në mes njerëzve.**
- **Të parandalojnë dhe zvoglojnë ndotjen** e sipërfaqeve dhe objekteve të përbashkëta nga ana e personave të infektuar.
- **Të parandalojnë ose zvoglojnë ekspozimin e njerëzve** ndaj sipërfaqeve ose objekteve të ndotura.

[Shkarkoni dokumentin](#) për të kuptuar më shumë detaje mbi zhvillimin e sigurt të zgjedhjeve gjatë një pandemie dhe emergjencash tjera të shëndetit publik.

Gjeni më shumë në [IFES COVID-19 Udhëzues për mbijetesën e demokracisë](#). Na kontaktoni në [media@ifes.org](mailto:media@ifes.org) për më shumë informacione.

---

**Autorët:**

**Dr. Fernanda Biril, hulumtuese e lartë**

**Dr. Stefan Darnof, Këshilltarë i lartë global për kryerjen e zgjedhjeve**

**Dr. Muluken Aseresa, këshilltar i lartë teknik, Management Sciences for Health**

**Kryeredaktorë:**

**Erika Shajn, Drejtor, Qenda për aplikim, hulumtim dhe mësim**

**Editorë:**

**Çad Vikeri, Nënkryetarë, Strategjia globale dhe udhëheqja teknike**

**Angela Kanterberi, Drejtoreshë për komunikime strategjike dhe hulumtuese**



International Foundation  
for Electoral Systems